



Breaking News:

DVP Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Tabachino”

⏸ ⏪ ⏩



LajmetOperacionet

16/07/2025

Tiranë/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Fokusi”. Goditet Një Rast I Armëmbajtjes Pa Leje

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Finalizohet operacioni policor i koduar “Fokusi”. Goditet një rast i armëmbajtjes pa leje.

Mbante armë zjarri pistoletë, kapet në flagrancë ndërkohë që qarkullonte në një automjet dhe vihet në pranga 31-vjeçari.

Procedohet penalisht drejtuesi i automjetit, për moskallëzim krimi.

Sekuestrohen pistoletë me municion luftarak, automjeti dhe 2 celularë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, mbi bazën e informacioneve të siguruar në rrugë operative për 2 shtetas që lëviznin me armë zjarri në automjet, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Fokusi”, si rezultat i të cilit u godit një rast i armëmbajtjes pa leje.

Gjatë operacionit, në urën e Babrojt, shërbimet e Policisë ndaluan automjetin me drejtues shtetasin F. B. dhe pasagjer E. M. Gjatë kontrollit në automjetit, në derën e pasagjerit, u gjet një armë zjarri pistoletë me municion luftarak, që dyshohet se e posedonte shtetasi E. M. Arma e zjarrit u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin.

Në vijim të veprimeve për rastin, u arrestua shtetasi E. M., 31 vjeç, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, dhe nisi procedimi penal për shtetasin F. B., 27 vjeç, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të dy banues në Tiranë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)